



Projekt – twinning i BE-së “Mbështetje në zbatimin e kornizës së modernizuar ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale”



TË DREJTAT E QYTETARËVE SI SUBJEKTE TË TË DHËNAVE PERSONALE



- 01 E DREJTA TË JESH I INFORMUAR
- 02 E DREJTA E QASJES
- 03 E DREJTA E KORRIGJIMIT
- 04 E DREJTA E SHLYERJES (“E DREJTA TË JESH I HARRUAR”)
- 05 E DREJTA E KUFIZIMIT TË PËRPUNIMIT
- 06 E DREJTA E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE
- 07 E DREJTA E KUNDËRSHTIMIT
- 08 E DREJTA QË MOS TË JETË LËNDË E VENDIMIT E CILA BAZOHET VETËM NË PËRPUNIMIN E AUTOMATIZUAR, DUKE PËRFSHIRË EDHE PROFILIMIN



Ky publikim u mundësua me përkrahje financiare të Bashkimit Evropian.

Përbajtja është përgjegjësi e autorit dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet të Bashkimit Evropian.

01 E DREJTA TË JESH I INFORMUAR

Personat fizikë kanë të drejtë të jenë të informuar për përpunimin e të dhënave të tyre personale. Mes tjerash, kontrolluesit janë të obliguar t'i informojnë personat fizikë për:



Në rastin kur të dhënat personale i marrin nga burimet e tjera, kontrolluesit janë të detyruar që personave fizikë, mes tjerash, t'u sigurojnë informata relevante për burimet dhe kategoritë e të dhënave personale.

Këto detyrime nuk zbatohen në rrethana të rralla kur personat fizikë tashmë kanë marrë informata të tilla.



“ SHEMBULL:

Një person regjistrohet për shfrytëzimin e shërbimeve të postës elektronike dhe pas regjistrimit i merr të gjitha informatat e përcaktuara në nenin 18 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Disa muaj më vonë, personi e aktivizon funksionin për dërgimin e instant mesazheve dhe prej tij kërkohet të sigurojë të dhëna plotësuese, respektivisht numër telefoni.

Në këtë rast, dhënësi i shërbimit do t'ia japë të gjitha informatat personit të përcaktuara me ligj në lidhje me përpunimin e numrave të telefonit (si p.sh. qëllimet, afatet e ruajtjes), por nuk ka për obligim t'i sigurojë informata që personi i ka marrë disa muaj më parë.



Ky paraqet kusht kryesor për transparencën dhe të gjitha informatat që sigurohen duhet të jenë koncize, transparente, të kuptueshme, lehtë të arritshme, dhe të jepen në gjuhën e qartë dhe të kuptueshme.

02 E DREJTA E QASJES

Personat fizikë kanë të drejtë të marrin konfirmim nga kontrolluesit nëse të dhënat e tyre personale përpunohen, të marrin kopje nga të dhënat e tyre personale dhe informata plotësuese për përpunimin, për shembull, qëllimet e përpunimit ose kategoritë e të dhënave personale që përpunohen.

“ SHEMBULL:

Një person mund të kërkojë kopje nga kontrata e tij për kredi nga banka ose kopje nga dosja e tij mjekësore në spital, sepse këto dokumente përmbajnë të dhëna personale për të.

Gjithsesi, duhet pasur parasysh se kontrolluesit (kompanitë, personat juridikë) mund të arkëtojnë për shpenzimet administrative për çdo kopje të radhës. Gjithashtu, realizimi i kësaj të drejte nuk guxon të ndikojë negativisht te personat e tjerë fizikë.



03 E DREJTA E KORRIGJIMIT

Personat fizikë kanë të drejtën e korrigjimit të të dhënave të tyre të pasakta personale në afat prej 15 ditëve pas parashtrimit të kërkesës.

Të dhënat personale konsiderohen të pa azhurnuara kur janë të pasakta ose të gabuara.

” SHEMBULL:

Një person ka kërkuar t'i dërgohet dokumentacioni i tij shëndetësor përmes e-mail të cilin klinika e ka ruajtur si informacion të kontaktit për të.

Personi konsideron se informata të cilën e ka klinika në lidhje me e-mail adresën është e pasaktë për shkak të faktit se nuk e ka marrë dokumentacionin e kërkuar në e-mail.

Përshkak të kërkesës së parashtruar nga personi, kontrolluesit transferimi duhet t'i hulumtojë dhe t'i korrigjojë informatat e kontaktit për personin në rastin e të dhënave të pasakta.



04 E DREJTA E SHLYERJES (“E DREJTA TË JESH I HARRUAR”)

Kjo e drejtë nuk është absolute dhe zbatohet vetëm në disa rrethana të caktuara:



Kjo e drejtë nuk zbatohet, mes tjerash, kur ka të bëjë me:

për vendosjen, realizimin ose mbrojtjen e kërkesave të bazuara me ligj

realizimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit (si p.sh. për qëllime gazetareske)

kur kontrolluesi ka obligim ligjor për përpunimin e të dhënave personale (si p.sh. përpunimi i evidencave për orarin e punës së të punësuarve)

në rastin e kryerjes së punëve me interes publik ose gjatë kryerjes së autorizimeve publike (si p.sh. për qëllimet e arkivimit me interes publik, për qëllimet e hulumtimeve shkencore dhe historike ose për qëllimet statistikore, nëse ekziston probabiliteti se fshirja mund ta bëjë përpunimin të pamundshëm ose seriozisht ta rëndojë arritjen e qëllimeve të përpunimit, ose gjatë zbatimit të regjistrimit të popullsisë në vend)



SHEMBULL:

Një klinikë merr kërkesë nga ish-pacienti për fshirjen e të gjitha të dhënave personale lidhur me të, përsëri, sigurimi në rast të përgjegjësisë që e ka klinika imponon që ajo t'i ruajë të dhënat e pacientit.

Klinika mund ta refuzojë kërkesën për fshirjen e të dhënave të personit, sepse ajo i përpunon të dhënat e tilla për qëllimet e realizimit të ndonjë të drejte të bazuar me ligj.



05 E DREJTA E KUFIZIMIT TË PËRPUNIMIT

Kjo e drejtë u lejon personave fizikë t'i kufizojnë mënyrat në të cilat kontrolluesit i shfrytëzojnë të dhënat e tyre personale në rrethana të caktuara (si p.sh. të dhënat personale janë me siguri të pasakta, përpunimi është i paligjshëm, nuk ekziston qëllimi valid i përpunimit, personi i kundërvihet përpunimit që bazohet në interesin legjitim të kontrolluesit).

Në ndonjë mënyrë, kjo e drejtë paraqet alternativë të kërkesës për shlyerjen e të dhënave personale.

“ ” SHEMBULL:

Organi kompetent zbaton hetim për vepër të caktuar penale, por duket se të dhënat personale për të dyshuarin të cilat janë marrë nga pala e tretë janë të pasakta (si p.sh. data e lindjes, dosja kriminale).

Organi nuk duhet t'i fshijë këto të dhëna, sepse ato paraqesin prova kundër të dyshuarit.

Megjithatë, shfrytëzimi i këtyre të dhënave duhet të kufizohet deri në mbledhjen e të dhënave të sakta.



06 E DREJTA E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE

Kur përpunimi i të dhënave personale bazohet në detyrimin kontraktues ose pajtimin dhe kryhet në mënyrë automatike, personat fizikë mund të kërkojnë transferimin e të dhënave nëse teknikisht është e realizueshme.

Kjo e drejtë është përcaktuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe e lehtëson shfrytëzimin e shërbimeve të caktuara nga ana e personave fizikë.

“ ” SHEMBULL:

Një person dëshiron ta ndërrojë bankën, sepse nuk është i kënaqur nga shërbimet e bankës së tanishme.

Personat fizikë mund të kërkojnë nga banka, si kontrollues, t'i transferojë të dhënat e tyre drejtpërdrejt në bankën tjetër, nëse kjo është teknikisht e realizueshme.



07 E DREJTA E KUNDËRSHTIMIT

E drejta e kundërshtimit zbatohet vetëm në rrethana të caktuara:

kur përpunimi i të dhënave personale ka të bëjë në kryerjen e autorizimit publik që i është besuar personit fizik

në rastin e kryerjes së punëve me interes publik

kur përpunimi kryhet për interesat legjitime të kontrolluesit ose të ndonjë personi të tretë

për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë

në kontekstin e shfrytëzimit të shërbimeve informatike

Si rrjedhojë, mund të thuhet se e drejta e kundërshtimit varet nga baza juridike e kontrolluesit për përpunimin dhe kjo mund të jetë më e kufizuar në rastin e përpunimit të qëllimeve të hulumtimeve shkencore / historike ose për qëllimet statistikore.

Duhet të theksohet se, më së voni deri në momentin e komunikimit të parë, personat fizikë duhet të jenë të njoftuar në mënyrë të qartë për këtë të drejtë, dhe kjo duhet të paraqitet në mënyrë të qartë dhe të ndarë nga informatat e tjera që u jepen.


” SHEMBULL:

Kompania ka probleme me sigurinë e hyrjes në hapësirat e saj dhe në bazë të interesit legjitim vendos sistem për video-mbikëqyrje.

Vizitori i kompanisë parashtron kundërshtim për përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit për video-mbikëqyrje.

Nëse kompania e refuzon kërkesën e tillë, ajo duhet të japë arsyetim të interesit legjitim për vazhdimin e përpunimit të tillë.

Në të kundërtën, konsiderohet se e drejta e personit fizik është shkelur.



E DREJTA QË MOS TË JETË LËNDË E VENDIMIT E CILA BAZOHET VETËM NË PËRPUNIMIN E AUTOMATIZUAR, DUKE PËRFSHIRË EDHE PROFILIMIN

Personat fizikë kanë të drejtë mos të jenë lëndë e vendimit e cila bazohet vetëm në përpunimin e automatizuar, duke përfshirë edhe profilimin.

Kjo ka të bëjë në miratimin e automatizuar të vendimeve pa asnjë përfshirje të faktorit njeri, që prodhojnë pasoja juridike për personin ose dukshëm ndikojnë mbi të.

Duhet pasur parasysh se kjo e drejtë nuk është absolute dhe nuk zbatohet nëse vendimi i tillë:

është i lejuar me ligj që zbatohet ndaj kontrolluesit

është i nevojshëm për lidhjen ose realizimin e marrëveshjes mes personit dhe kontrolluesit

bazohet në pajtimin e qartë nga personi



SHEMBULL:

Online vendimi për ndarjen e kredisë ose testit për vlerësimin e aftësisë dhe karakteristikave të personalitetit të kandidatit për punë që shfrytëzon algoritme dhe kriterë të programuara paraprakisht është vendimi i cili bazohet në përpunimin e automatizuar pa përfshirjen e faktorit njeri i cili prodhon pasoja juridike ndaj personit të prekur.



SCAN ME

Për më shumë informacione www.azlp.mk

